



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
KOMISIONI ZGJEDHOR I FAKULTETIT TË EKONOMISË

Nr. 6 Prot

Datë, 27.03.2020

VENDIM

Nr. 3, datë 27.03.2020

PËR

**SHTYRJEN E PROCESIT TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE PËR
DREJTUES TË NJËSISË KRYESORE, DREJTUES TË NJËSISË BAZË, PËR
ANËTARËT E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME NË NJËSINË KRYESORE NË
FAKULTETIN E EKONOMISË NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI" VLORE.**

Në zbatim të Ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; në zbatim të nenit 7 pika 6/d, nenit 18, pika 3 të Vendimit të Senatit Akademik Nr.59, datë 11.02.2020 "Për miratimin e Rregullores për organizmin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë; Vendimit Nr.1, datë 20.03.2020 "Për Shpalljen e fituesit të Kryetarit të Komisionit Zgjedhor pranë Fakultetit të Ekonomisë (KZFE); si edhe Urdhrit të Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 99, datë 26.03.2020 "Për disa ndryshime në Urdhrin Nr. 8, datë 14.01.2020 "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë", Komisioni Zgjedhor i Fakultetit:

VENDOSI:

1. Të miratojë shtyrjen e procesit të regjistrimit të kandidatëve për Drejtues të Njesisë Kryesore, Drejtues të Njesisë Bazë, për Anëtarët e Komisioneve të Përhershme në Njësinë Kryesore në Fakultetin e Ekonomisë në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë.
2. Të miratojë periudhën kohore të regjistrimit të kandidatëve nga data 24.04.2020 deri në datën 28.04.2020, brenda orarit zyrtar 8:00-16:00.
3. Procesi i regjistrimit kryhet kur kandidati paraqitet personalisht në zyrën e Komisionit Zgjedhor të Fakultetit të Ekonomisë për të depozituar dokumentacionin për kandidim. Pas regjistrimit, kandidatit i jepet vërtetimi i regjistrimit si kandidat nga Komisioni Zgjedhor i Fakultetit të Ekonomisë.
4. Vendimi publikohet në të gjitha mjediset e Fakultetit të Ekonomisë në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë dhe në faqen zyrtare www.univlora.edu.al.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar i Komisionit Zgjedhor të Fakultetit:

Grigor Dede

Ilira Pulaj (Anëtare)

Desantila Ahmeti (Anëtare/studente)

Briseida Ramaj (Sekretare)